

VENDIM
Nr.134, datë 14.3.2007

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 123.2 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Pas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 247, të shtohen shkronjat “c/1”, “c/2”, “c/3”, “c/4”, e “c/5”, me këtë përmbajtje:

- “c/1. Mallrat, të cilat shërbejnë si lëndë e parë për industrinë përpunuese vendase.
- c/2. Mallrat, që depozitohen në magazina publike, me destinacion riekspordin apo për afate të shkurtra kohore, me qëllime logjistike, deri në kryerjen e veprimeve në dogana (1-2 muaj).
- c/3. Mallrat, të cilat janë pjesë ekskluziviteti në tregtim, për tregun e brendshëm dhe atë rajonal.
- c/4. Mallra me destinacion tregtimin në dyqanet e tipit *Duty Free Shop*.
- c/5. Mallra me destinacion furnizimin e bordeve, veprimtarive apo personave të tjerë, që, për shkak të statusit apo legjislacionit shqiptar, përfitojnë mallra të pataksuara me detyrime importi.”.

Neni 2

Në kreun II të titullit III, pas pikës 8 të nenit 248, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Subjekti, që aplikon për licencë për ushtrimin e veprimtarisë *duty free*, duhet të plotësojë këto kriterë:

- a) Të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës të Shqipërisë dhe të jetë i pajisur me certifikatën tatimore;
- b) Të ketë përvojë jo më pak se 5 vjet në fushën e operimit të *duty free* apo të veprimtarive të tjera, të ngjashme;
- c) Të ketë qarkullimin vjetor total për tri vitet e fundit, jo më të vogël se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;
- ç) Të ketë numër mesatar të punonjësve për tri vitet e fundit, jo më të vogël se 8;
- d) Të depozitojë garanci bankare prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh;
- dh) Të paguajë një çmim vjetor të pakthyeshëm prej 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekësh, për metër katror;
- e) Të jetë i pajisur me të drejtat ekskluzive tregtare të markave dhe tipeve të produkteve, që do të tregojë apo me aplikime certifikatash për mallrat elektronike;
- ë) Të jetë i pajisur me një sistem menaxhimi elektronik dhe të sigurtë, të mbështetur nga një software, për mbajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit, duke u lidhur drejtpërdrejt me sistemin ASCUDA, të Doganës. Sistemi elektronik duhet të mbështesë riprogramime dhe “Costumise”, për të dhëna shtesë, që mund të kërkohen;
- f) Të jetë i pajisur me një sistem skanimit të inventarit si në hyrje dhe në dalje, si dhe të “Bording pass”, të pasagjerëve, që paraqiten si klientë të dyqanit;
- g) Të paraqesë pranë Ministrisë së Financave:
- i) planin e hollësishëm financiar të biznesit, duke argumentuar qarkullimin vjetor të parashikuar, numrin e mallrave, që do të tregtohen, mënyrën e tregtimit dhe të manifestimit të mallit;
- ii) planin organizativ të zhvillimit të biznesit, duke dhënë hollësi për ndarjen e punës;
- iii) planin e magazinimit të mallit, ku përfshihen:

- dokumenti i stokut;
- autorizimet;
- gjetja e vendndodhjes së mallit;
- personeli i magazinës;
- dokumentet e përdorura për çdo lëvizje malli.

gj) Të paraqesë metodat e përdorura për auditim të brendshëm apo për kontrollin e veprimtarive, si dhe dokumentimin e këtyre proceseve;

h) Të jetë i pajisur me një sistem ruajtjeje alarmi;

i) Të ketë tregues eficientë ekonomikë për kthimin e qarkullimit vjetor, vitet e kthimit të investimit.

Ngarkohet Ministri i Financave që në rast pas rasti të emërojë komitetin e shqyrtimit të dokumentacionit për licencat e *duty free*, i cili në përputhje me kriteret e përshkruara më sipër, përcakton, në mënyrë të hollësishme dokumentet e plota, teknike dhe financiare, të përzgjedhjes së operatorëve *duty free*. Komiteti, brenda shtatë ditëve, shqyrton dokumentacionin dhe i paraqet Ministrin të Financave praktikën e operatorëve, të cilët plotësojnë kriteret.

Ministri i Financave, brenda tri ditëve, miraton lëshimin e licencave për operatorët, që plotësojnë kriteret. Licenca është e vlefshme për 7 vjet, me të drejtë rinovimi.”.

Neni 3

Subjektet, që, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë të pajisura me licenca për ushtrimin e veprimtarisë *duty free*, marrin masat e nevojshme, që, brenda një periudhe tremujore të përshtaten me kriteret e reja. Në rast se pas kalimit të kësaj periudhe, nuk është plotësuar qoftë edhe një kriter i vetëm, licenca e tyre vlerësohet e pavlefshme.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha